



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

LISTË VERIFIKIMI PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË KRITEREVE LIGJORE MBI
NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E ORGANEVE KOLEGJIALE NË SHKOLLË
(KOMISININ E DISIPLINËS)

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË KRITEREVE LIGJORE MBI NGRITJEN DHE
FUNKSIONIMIN E ORGANEVE KOLEGJIALE NË SHKOLLË (KOMISININ E DISIPLINËS)

Në zbatim të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vkm nr. 99, datë 27.02.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", e ndryshuar, me vkm nr. 129, datë 06.03.2024, Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", miratuar me urdhrin nr. 4699/1 prot., datë 30.04.2019, urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, për miratimin e "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", udhëzimit nr. 30, datë 02.08.2013, "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore".

Nr	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
.				

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
1	Pika 2, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A janë hartuar nga komisioni i disiplinës së shkollës, rregullat e disiplinës shkollore, a janë diskutuar me grupet e interesit, a janë miratuar nga ZVA-ja dhe a janë bërë të njohura në çdo fillim viti shkollor?		
2	Pika 3, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A janë parashikuar në rregulloren e brendshme të IA-së rregullat e disiplinës dhe masat, referuar rregullores tip, të miratuar nga ministri?		
3	Pika 4, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A kanë rol dhe dimension edukativ, masat disiplinore të parashikuara në rregulloren e IA-së?		
4	Pika 5, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka trajtuar komisioni i disiplinës sjelljet që vijnë në shkelje të rregullave të disiplinës shkollore?		
5	Pika 6, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A janë marrë masa disiplinore ndaj nxënës/ve që manifestojnë sjellje të papranueshme e të qortueshme, që nuk përputhen me rregullat e disiplinës shkollore, që çënojnë procesin mësimor, misionet pedagogjike, edukative e arsimore dhe që çënojnë klimën miqësore në klasë/shkollë?		
6	Pika 7, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka evidentuar, personeli mësimdhënës i IA-së, gjatë veprimtarisë së tij, raste të shkeljeve të rregullave të disiplinës nga nxënësi?		
7	Pika 7, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka qortuar, personeli mësimdhënës i IA-së, gjatë veprimtarisë së tij, raste të shkeljeve të rregullave të disiplinës nga nxënësi?		
8	Pika 7, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka parandaluar, personeli mësimdhënës i IA-së, gjatë veprimtarisë së tij, raste të shkeljeve të rregullave të disiplinës nga nxënësi?		
9	Pika 7, neni 100, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka informuar personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për rastet e shkeljeve të rregullave të disiplinës nga nxënësi?		
10	Pika 1, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka ngritur institucion i arsimor në fillim të çdo viti shkollor, komisionin e disiplinës, të përbërë nga 5-7 persona?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
11	Pika 2, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është i përbërë komisioni i disiplinës nga: drejtori i IA-së nëndrejtorët (nëse shkollë ka) dhe mësues të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, me shumicë të thjeshtë dhe me votim të fshehtë?		
12	Pika 3, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është i kryesuar komisioni i disiplinës nga drejtori i IA-së?		
13	Pika 4, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka zgjedhur këshilli i mësuesve, në fillim të vitit shkollor, edhe një mësues si anëtar rezervë për komisionin e disiplinës, vetëm për rastet kur mungon njëri prej anëtarëve apo kur çështja që merr në shqyrtim komisioni, lidhet me një prej anëtarëve të tij?		
14	Pika 5, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A i ka marrë vendimet komisioni i disiplinës në shkollë, me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij dhe me votim të fshehtë?		
15	Pika 6, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka shqyrtuar komisioni i disiplinës në shkollë, rastet e konstatuara nga komisioni i etikës dhe sjelljes për shkeljet disiplinore të kryera nga nxënësit, mësuesit dhe nëndrejtorët?		
16	Pika 7, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka patur raste të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore të një anëtari të komisionit të disiplinës, nga vetë komisioni, por pa praninë e tij?		
17	Pika 8, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka marrë pjesë në mbledhjen e komisionit të disiplinës kur është trajtuar shkelja e rregullave disiplinore nga ana e nxënësit, nxënësi për të cilin shqyrtohet shkelja, mësuesi kujdestar i tij, psikologu apo punonjësi social, si dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tij?		
18	Pika 9, neni 101, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është shoqëruar në mbledhje çdo nxënës, me një “mbrojtës” të tij, që mund të ketë qenë një person brenda apo jashtë shkollës, i zgjedhur nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
19	Pika 1,2,3,4,5, 6, neni 102, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është marrë masa disiplinore duke respektuar : - parimin e ligjshmërisë? - parimin “ne bis in idem”? - parimin e dialogimit? - parimin e proporcionalitetit? - parimin e individualizimit? - parimin e arsytimit të masës disiplinore?		
20	Pika 1,2,3,4,5,6,7,8, neni 103, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është siguruar nga institucioni arsimor mosaplikimi i masave që: - çënojnë dinjitetin e nxënësit? - përfshijnë dhunë të çdo forme? - përjashtojnë nxënësit pa mbikëqyrës nga mësimi? - ndalojnë pjesëmarrjen në veprimtaritë shkollore? - i mban nxënësit pas mbarimit të mësimin në arsimin fillor? - janë me gjorbë dhe dënim monetar? - janë kolektive për një grup nxënësish? - lejojnë sekuestrimin përfundimtar ose për një kohë të gjatë të sendeve personale të ndaluara në shkollë, që u përkasin nxënësve, si; telefonat celularë, aparatura muzikore, video game etj.?		
21	Pika 8, neni 103, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A i ka kërkuar mësuesi nxënësit t’ia japë atij objektin (sendeve personale të ndaluara në shkollë) dhe a ia ka kthyer atë brenda një kohe “të arsyeshme” (fundi i ditës)?		
22	Pika 1, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është bërë ndarja e masave disiplinore në masa disiplinore të lehta dhe disiplinore të rënda?		
23	Pika 3, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është siguruar që të mos shënohen masat disiplinore të lehta në dosjen individuale të nxënësit, në karakteristikën e nxënësit?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
24	Gërma a,b,c,ç,d, pika 4, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	<p>A ka dhënë mësuesi masë disiplinore të lehtë, të parashikuar në rregulloren e brendshme të shkollës, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shënim në fletore për të cilin është kërkuar nënshkrimi nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore? - ndjesë para klasës? - dhënia e detyrave shtesë (me konfirmimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, duke u realizuar nën vëzhgimin e mësuesit)? - mbajtja përtej orëve të mësimit të nxënësit të arsimit të mesëm, për të kryer punë në shërbim të shkollës (jo më shumë se një orë dhe me konfirmimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore) - masa të tjera disiplinore të lehta të parashikuara në rregulloren e brendshme të IA-së? 		
25	Pika 5, neni 104, kreu XVIII, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka paraqitur nxënësi versionin e tij të fakteve, përpara marrjes së masës disiplinore të lehtë?		
26	Pika 5, neni 104, kreu XVIII, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është dhënë masa disiplinore e lehtë, në proporcion me shkeljet e kryera dhe të individualizuara?		
27	Pika 6, neni 104, kreu XVIII, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A janë aplikuar masat disiplinore të rënda vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm, për sjellje dhe veprime të rënda dhe të përsëritura, të cilat bien në kundërshtim me rregullat e parashikuara në funksion të procesit mësimor dhe jetës shkollore, në veçanti sjelljet e rënda ndaj personave dhe pronës?		
28	Pika 7, neni 104, kreu XVIII, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A janë shënuar masat disiplinore të rënda në karakteristikën e nxënësit dhe në dosjen personale?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
29	Pika 8, neni 104, kreu XVIII, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A janë dhënë masat disiplinore të rënda nga komisioni i disiplinës?		
30	Pika 9, neni 104, kreu XVIII, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka marrë komisioni i disiplinës për dhënien e masës disiplinore të rëndë, në konsideratë personalitetin e nxënësit, si dhe kontekstin në të cilin është kryer shkelja?		
31	Gërma a/i,ii,iii pika 10, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është përfshirë në masën disiplinore të rëndë “Paralajmërim për ulje të notës në sjellje” ku komisioni: - ka realizuar me shkrim vendimin, - njofton me shkrim, nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, apo përfaqësuesit të tij ligjor, të cilët kanë konfirmuar me shkrim njoftimin për masën disiplinore, - shoqërohet (nëse është e nevojshme)nga një masë me natyrë edukative.		
32	Gërma b/i,ii,iii, pika 10, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është përfshirë në masën disiplinore të rëndë “Ulje e notës në sjellje”, ku komisioni: - jep masën vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë, - njofton me shkrim nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore apo përfaqësuesit e tij ligjor, të cilët kanë konfirmuar se kanë marrë njoftim për masën, - e bën pjesë të dosjes personale të nxënësit.		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
33	Gërma c/i,ii,iii, pika 10, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është përfshirë në masën disiplinore të rëndë kontributi në shërbim të IA-së apo komunitetit, ku komisioni: - njofton me shkrim nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tij apo përfaqësuesit ligjor, të cilët kanë konfirmuar se kanë marrë djeni, - siguron kontributin e nxënësit jashtë orëve të mësimit, në veprimtari solidariteti, kulturore ose trajnuese, ose në kryerjen e një detyre për qëllime edukimi për një periudhë kohore të përcaktuar nga komisioni i disiplinës, që në total nuk i ka kaluar njëzet orë përgjatë vitit shkollor, e cila është brenda IA-së apo një autoriteti lokal, - e bën pjesë të dosjes personale të nxënësit.		
34	Gërma d/i,ii,iii, pika 10, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është përfshirë në masën disiplinore të rëndë, “Përrjashtim i nxënësit nga IA-ja”, ku komisioni: - e jep vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (pasi komisioni ka shfrytëzuar çdo mënyrë tjetër), - informon Njësinë administrative bashkiake ku ka vendbanimin nxënësi, për kohëzgjatjen e masës disiplinore të rëndë për përjashtim të përkohshëm ose të përhershëm nga shkolla.		
35	Pika 11, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka parashikuar komisioni i disiplinës i IA-së, një afat kohor, kur nuk ka aplikuar menjëherë masën disiplinore të rëndë dhe ka paralajmëruar nxënësin se përsëritja e veprimit do të çonte në marrjen e vendimit për dhënien e masës përfundimtare?		
36	Pika 12, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka vepruar Komisioni i disiplinës në rastet e dhunës fizike ndaj një mësuesi, edhe kur nuk ka pasur ankesë?		
37	Pika 13, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë	A ka mundësuar komisioni i disiplinës krijimin e një grupi arsimor me mësuesit e institucionit, për të zgjidhur një çështje edukative të personalizuar?		
38	Pika 14, neni 104, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A u është shpjeguar nxënësit dhe personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, çdo masë disiplinore, duke iu argumentuar atyre qëllimin e marrjes së masës?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
39	Pika 1,2 neni 105, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	<p>A ka marrë drejtori i institucionit arsimor masën e pezullimit ndaj punonjësit arsimor, në rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kur gjykata ka vendosur masë sigurimi personal, deri në ndryshimin e masës? - kur është kandidat për zgjedhjet vendore apo politike nga puna, deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në fund të mandatit? 		
40	Pika 3, neni 105, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka përfunduar masa e pezullimit me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra dhe a i janë ndërprerë punonjësit arsimor të pezulluar, marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit?		
41	Gërma a,b,c, pika 1, neni 107, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	<p>A ka dhënë komisioni i disiplinës i institucionit arsimor, masë disiplinore për mësuesin ose nëndrejtorin, kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka konstatuar shkelje të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar, të kësaj Rregulloreje ose të rregullores së brendshme të institucionit? - kur ka konstatuar shkelje të dispozitave të Kodit të Etikës e të sjelljes në institucion? - kur ka konstatuar rezultate fiktive të përsëritura të nxënësve, të verifikuara në mënyrë objektive, nëpërmjet testimave të drejtorisë së institucionit ose të DRAP-it apo rezultateve të provimeve kombëtare? 		
42	Gërma ç, pika 1, neni 107, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka dhënë komisioni i disiplinës i institucionit arsimor, masë disiplinore për nëndrejtorin, kur drejtori i shkollës ka konstatuar se nëndrejtori nuk ka kryer detyrat e tij sipas përshkrimit të punës?		
43	Gërma a,b,c,ç, pika 2, neni 107, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	<p>A ka vendosur komisioni i disiplinës i IA-së, masë disiplinore të përshkallëzuar në varësi të llojit të shkeljeve apo përsëritjeve të së njëjtës shkeljeje, për mësuesin ose nëndrejtorin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “Qortim”, - “Vërejtje”, - “Paralajmërim për largim nga puna”, - “Largim nga puna”. 		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
44	Pika 4, neni 107, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A ka patur raste kur komisioni i disiplinës në rastet e përsëritjes së shkeljes nga mësuesi/nëndrejtori, i cili ka marrë më parë masën “Paralajmërim për largim nga puna”, i ka propozuar drejtorit të IA-së fillimin e procedurave për largimin nga puna të mësuesit/nëndrejtorit?		
45	Pika 4, neni 107, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është shlyer masa, kur, për një periudhë gjashtëmujore, komisioni i disiplinës i IA-së nuk ka shqyrtuar shkelje tjetër të mësuesit/nëndrejtorit?		
46	Pika 5, neni 107, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është dhënë masë disiplinore “Largim nga detyra”, në rastet kur mësuesi/nëndrejtori ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit dhe këto veprime janë provuar?		
47	Gërma a,b,c,ç,d,dh, pika 1, neni 108, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A është kryer mbarimi i marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar, kur: - ka dhënë dorëheqjen? - ka mbushur moshën e pensionit? - është bërë i paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike ose mendore, të provuara me raport mjeko-ligjor? - është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për çështje që lidhen me ushtrimin e profesionit? - është marrë masa disiplinore e largimit nga puna? - IA-ja nuk ka ofruar ngarkesë mësimore lëndore?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
48	Gërma a,b,c,ç,d,dh,e,ë,f,g,gj,h pika 2, neni 108, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	<p>A ka filluar drejtori i IA-së procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka falsifikuar dokumente zyrtare dhe ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit? - ka ushtruar dhunë fizike ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit? - ka ngacmuar seksualisht nxënës ose punonjës të institucionit? - ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të institucionit? - ka organizuar kurse me pagesë me nxënësit që mëson dhe me nxënësit të IA-së? - ka organizuar kurse me pagesë jashtë IA-së dhe nuk ka qenë i licencuar për të ushtruar këtë veprimtari private? - ka pasur mosarritje të nxënësve të tij, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 60 të LAPU-së? - i është rekomanduar në raportin e monitorimit dhe të vlerësimit? - ka kryer korrupsion pasiv? - ka kryer shkelje të dispozitave të Kodit të Punës dhe të legjislacionit në fuqi? - i është rekomanduar me shkrim nga komisioni i disiplinës së shkollës? 		
49	Pika 3, neni 108, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A janë kryer sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe në legjislacionin në fuqi, procedurat e largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar?		

INSPEKTORËT